



**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

Tipi: Privat

Nr./Dt. 04-052-2791/3

Data/Date: 09.01.2018

**RAPORT  
I INSPEKTIMIT MBI MENAXHIMIN E PROKURIMIT NË POLICINË E  
KOSOVËS**

Nr. 5/2017

Prishtinë, 5 janar 2018

**Titulli** Raport i inspektimit mbi menaxhimin e prokurimit në Policinë e Kosovës

**Data e përgatitjes** 5 janar 2018

**Përgatitur nga** Bekim Pira, inspektor (udhëheqës i ekipit),  
Servet Tasholli, inspektor,  
Linda Ahmeti

**Mbikëqyrur nga** Ilir Idrizaj,  
Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit

**Mbështetur nga** Bujar Mustafa,  
Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi

**Dorëzuar nga** Bekim Pira,  
Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit

**Miratuar nga** Hilmi Mehmeti,  
Kryeshf Ekzekutiv  
Inspektorati Policor i Kosovës

**Data e miratimit** 5 janar 2018



## Informata të përgjithshme

---

<b>Titulli</b>	Raport i inspektimit mbi menaxhimin e prokurimit në Policinë e Kosovës
<b>Data e përgatitjes</b>	5 janar 2018
<b>Përgatitur nga</b>	Bekim Pira, inspektor (udhëheqës i ekipit), Servet Tasholli, inspektor, Linda Ahmeti
<b>Mbikëqyrur nga</b>	Illir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
<b>Mbështetur nga</b>	Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
<b>Dorëzuar nga</b>	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
<b>Miratuar nga</b>	Hilmi Mehmeti, Kryeshef Ekzekutiv Inspektorati Policor i Kosovës
<b>Data e miratimit</b>	5 janar 2018

### 1. Përmbledhja ekzekutive

- 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-5)
- 1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....(4-5)

### 2. Hyrje

- 2.1 Arsyet e inicimit të inspektimit.....(6-6)
- 2.2 Qëllimi.....(6-6)
- 2.3 Objekti.....(6-6)
- 2.4 Subjekti.....(6-6)
- 2.5 Objektivat e inspektimit.....(7-7)
- 2.6 Rëndësia e inspektimit.....(7-7)
- 2.7 Metodologjia e inspektimit.....(7-7)
- 2.8 Periudha e kryerjes së inspektimit.....(7-7)
- 2.9 Periudha e mbulimit të inspektimit.....(7-7)
- 2.10 Drejtimet e inspektimit.....(7-7)
- 2.11 Kriteret e vlerësimit.....(8-8)
- 2.12 Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....(8-8)

### 3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

- 3.1 Kapacitetet dhe funksionimi i Drejtorisë në fushën e prokurimit.....(9-10)
- 3.2 Administrimi i aktiviteteve të prokurimit.....(10-18)

### 4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

- 4.1 Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(19-20)

Shtojcat

## 1. Përmbledhja ekzekutive

---

### 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit

1.1.1. Drejtoria e Prokurimit (*në tekstin e mëtejme Drejtoria*) ka kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe profesionale për të përmbushur kërkesat, nevojat dhe për të ushtruar aktivitetet operacionale prokuruese përbrenda kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP). Në fushën e organizimit të brendshëm struktural, në kuadër të Drejtorisë duhet të përmyllet procesi i ndarjes sektoriale. Personeli i angazhuar në Drejtori vlerësohet se ka kapacitetet e mjaftueshme profesionale, mbështetur nga programet adekuate trajnuese certifikuese. Inspektimi ka vënë në pah një bashkëpunim dhe koordinim të mirë në mes të disa akterëve të përfshirë apo të ndërlidhur me funksionet prokuruese, Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA), Drejtorisë së Buxhetit e Financave (DBF), Njësive kërkuese dhe Drejtorisë së Prokurimit.

1.1.2. Drejtoria ka kryer dhe ka nxjerr me kohë Planifikimin e Prokurimit për vitin fiskal 2016, që ka reflektuar me nevojën që në të ardhmen, planifikimet e projekteve në kornizën prokuruese vjetore të jenë më gjithëpërfshirëse, më të qëndrueshme dhe më përmbajtësore. Drejtoria ka qenë aktive në administrimin e aktiviteteve gjatë të gjitha fazave të prokurimit, konform përgjegjësiave menaxheriale dhe operacionale. Drejtoria ka përmbushë obligimin ligjor për raportimin vjetor në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), rreth dorëzimit të Raportit të Kontratave Publike të Nënshkruara. Është identifikuar avancim në mbajtjen e dosjeve të prokurimit, qoftë si përmbajtje apo si vendosje dhe sistemim në hapësira adekuate. Dosjet në formën e një Regjistri Përmbledhës të Prokurimit janë më të plota dhe më të kompletuara.

1.1.3. Autoriteti Kontraktues (AK) në këtë rast Drejtoria, ka obligim dhe përgjegjësi për të zhvilluar aktivitete prokuruese duke respektuar parimet e konkurrencës, efikasitetit, efektivitetit, objektivitetit, mos-diskriminimit, integritetit, transparencës, llogaridhënies dhe profesionalizmit. Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është interesuar të vlerësojë se sa përfillen standardet e larta profesionale nga Drejtoria, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikatat më të mira. Herën e fundit kur është kryer inspektimi, janë adresuar një numër çështjesh, për të cilat janë dhënë një numër rekomandimesh. Këtë vit, ekipi inspektues ka kontrolluar më se 30 dosje të aktiviteteve prokuruese dhe gjetjet i ka paraqitur sipas hapave të prokurimit, përfshirë planifikimin e prokurimit; parashikimin e vlerës dhe klasifikimin e kontratës; përgatitjen e dosjes tenderuese; publikimin e njoftimeve; hapjen dhe vlerësimin e tenderëve; dhënien dhe nënshkrimin e kontratës; dhe menaxhimin e kontratës.

1.1.4. Duke krahasuar gjendjen e konstatuar në inspektimin e kaluar me performancën aktuale të Drejtorisë, shihet lëvizje pozitive në shume drejtime. Ndryshimet vërehen në përgatitjen me kohë të Dosjeve të Tenderit (DT) para Njoftimit të Kontratës, vendosjen e afateve kohore për dorëzimin e tenderëve, përgatitjen e Specifikimeve Teknike (ST) dhe Termave të Referencës (TR). Shihet një mobilizim i Drejtorisë në drejtim të eliminimit të disa dukurive që kanë qenë në kundërshtim me legjislacionin aktual, siç ishin: plotësimi i dosjeve tenderuese nga persona të njëjtë, nënshkrimi i kontratave pasi që furnizimet ishin kryer dhe konkurrenca e kufizuar. Është konstatuar se publikimi i Njoftimeve të Kontratave është bërë në të gjitha rastet e ekzaminuara, ka lëvizje pozitive edhe sa i përket fillimit dhe përfundimit të periudhës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve brenda afateve kohore. Po ashtu, nuk është hasur në kontrata të nënshkruara para kohe.

1.1.5. Inspektimi gjithashtu ka konstatuar disa drejtime, në të cilat nevojitet përmirësim i gjendjes. Janë këto disa pika në të cilat duhet punuar në të ardhmen, me çka do të ngrihej në nivel më të lartë performanca e Drejtorisë. Duhet punuar në nxjerrjen e planeve më të qëndrueshme të prokurimit, në prodhimin e Regjistrave të operatorëve ekonomik (OE) të kontaktuar, në nxjerrjen e Procesverbaleve të çmimeve të kuotuar, lëshimin apo dorëzimin me kohë të DT-ve kur parashtrihen kërkesa për to. Vërehen dobësi në respektimin e afateve kohore të hapjes së tenderëve, të mos nënshkrimit të Procesverbaleve të hapjes së tenderëve nga personat përkatës të prokurimit. Janë ekzaminuar disa raste ku komisionet e vlerësimit nuk kanë pasur qasjen e nevojshme për vlerësimin e tenderëve bazuar në kriteret e përcaktuara të përzgjedhjes. Janë ekzaminuar disa aktivitete të prokurimit kur publikimet e Njoftimeve për Dhënie të Kontratave është bërë jashtë afatit të përcaktuar. Është e nevojshme që të merren parasysh udhëzimet e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik (UOPP), në respektimin e udhëzimeve mbi hapat në caktimin e menaxherëve të projekteve, nxjerrjen dhe nënshkrimin e Planeve të Menaxhimit të Kontratave dhe lëshimit të Urdhër blerjeve.

## **1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve**

1.2.1. Nga inspektimi rezultoi se nga 22 rekomandime të lëna nga inspektimi i kaluar (Vlerësimi i kryerjes së detyrave në Drejtorinë e Prokurimit të Policisë së Kosovës, nr. 6/2013), gjithsej janë përmbushë 15 rekomandime, katër (4) prej tyre janë përmbushë në masë të madhe (përgjithësisht), dy (2) janë përmbushë pjesërisht, kurse një (1) nuk është përmbushë fare. *Për më tepër referoju tabelës në shtojcë.*

## **2. Hyrje**

---

### **2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit**

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK-ja ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Policinë e Kosovës (PK), për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave policore. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështet Policinë, për të siguruar një shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit të IPK-së, për vitin 2017 ka përfshirë kryerjen e inspektimeve në disa fusha të menaxhimit, përfshirë edhe menaxhimin e prokurimit në PK. Prokurimi paraqet fushë me interes për palët, si brenda, po ashtu edhe jashtë Policisë, për t'u njohur me mënyrën e shpenzimit të fondeve, për të përmbushur nevojat operative dhe administrative. Kjo fushë me ndjeshmëri të lartë, shtron kërkesën që IPK të zhvillojë inspektim drejt dhënies së një vlerësimi mbi respektimin e parimeve të transparencës, efikasitetit, efektivitetit dhe dobisë ekonomike në shfrytëzimin e mjeteve të siguruara nga taksat e qytetarëve. PK-ja është vlerësuar si një organizatë e suksesshme, andaj kjo fushë përbën një rrezik të mundshëm për rënie të besimit dhe përgjithësisht të suksesit të saj. Me këtë inspektim shtohet numri i instrumenteve të kontrollit të brendshëm, drejt shfrytëzimit të drejtë të burimeve dhe evitimit të mundësive për keq-menaxhim të mundshëm të mjeteve buxhetore.

### **2.2. Qëllimi i inspektimit**

2.2.1. Qëllimi i këtij inspektimi është:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregullat dhe udhëzimet përkatëse zbatohen si duhet, dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet e saj,
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj,
- Që të jepet opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me fushën e prokurimit,
- Që të parandalojë shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë veprimtarisë së PK-së në fushën përkatëse,
- Të identifikojë mangësitë apo dobësitë dhe të rekomandojë masa ligjore dhe organizative për funksionimin më të mirë të PK-së.

### **2.3. Objekti i inspektimit**

2.3.1. Në këtë inspektim është vlerësuar kryerja e detyrave policore në fushën e menaxhimit të prokurimit në PK.

### **2.4. Subjekti i inspektimit**

2.4.1. Inspektimi është përqendruar në Drejtorinë e Prokurimit në kuadër të Departamentit për Shërbime Mbështetëse të PK-së.

## **2.5. Objektivat e inspektimit**

2.5.1. Objektivat që ka synuar t'i arrijë ky inspektim janë:

- Vlerësimi i ligjshmërisë në aktivitetet prokuruese të realizuara nga Autoriteti Kontaktues,
- Vlerësimi i ekonomizimit, efikasitetit dhe dobisë ekonomike gjatë realizimit të kontratave me operatorët ekonomikë.

## **2.6. Rëndësia e inspektimit**

2.6.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Përmirësimin e shërbimeve për të siguruar shkallë më të lartë të transparencës, ekonomizimit, efikasitetit dhe dobisë ekonomike,
- Ngritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies në shpenzimin racional të fondeve publike,
- Shtimin e masave të kontrollit pro-aktiv për minimizim të mundësive për përfshirje në veprime korruptive.

## **2.7. Metodologjia e inspektimit**

2.7.1. Gjatë inspektimit:

- a) Janë zhvilluar intervista dhe takime me zyrtarët si në vijim:
  - Udhëheqësin e Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse,
  - Drejtorin e Drejtorisë së Prokurimit.
- b) Janë kryer vëzhgime, këqyrje apo kontrollime të 30 dosjeve të prokurimit (2016).
- c) Janë siguruar dëshmitë, si në vijim.
  - Planifikimi i Prokurimit për vitin 2016,
  - Raporti Vjetor i Kontratave Publike të Nënshkruara (2016),
  - Kopjet e dosjeve të kontrolluara për vitin 2016 (30 sosh),

## **2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit**

2.8.1. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar me datë 21.02.2017 dhe ka përfunduar më datë 22.02.2017.

## **2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit**

2.9.1. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave policore gjatë periudhës kalendarike janar- dhjetor 2016. Veç tjerash, inspektimi është fokusuar edhe në fazën e përgatitjes së Planifikimit të Prokurimit në fund-vitin 2015.

## **2.10. Drejtimet e inspektimit**

2.10.1. Për përmbushjen e objektivave të vëna, inspektimi është përqendrohet në këto drejtime:

- Kapacitetet dhe funksionimi i Drejtorisë në fushën e prokurimit,
- Administrimi i procedurave të prokurimit.



## **2.11. Kriteret e vlerësimit**

2.11.1. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave në departament dhe drejtorinë përkatëse:

- Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092,
- Rregullore për Prokurimin Publik,
- Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik,
- Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik,
- Planifikimi i Prokurimit për vitin fiskal 2016,
- Raporti Vjetor i Kontratave Publike të Nënshkuara (2016),
- Dosjet e tenderëve të ekzaminuar.

## **2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave**

2.12.1. Departamenti i Inspektimit gjatë tërë procesit të inspektimit nuk ka hasur në ndonjë pengesë që do të ndikonte në rrjedhën e punës në terren dhe raportimit të gjetjeve. Andaj, vlerësojmë se është hasur në një bashkëpunim shumë të afërt me personelin e Drejtorisë së Prokurimit. IPK-ja çmon gatishmërinë e personelit në ofrimin e informacionit të nevojshëm mbi aktivitetet prokuruese.

### **3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet**

---

#### **3.1. Kapacitetet dhe funksionimi i Drejtorisë në fushën e prokurimit**

3.1.1. Drejtoria e Prokurimit funksionon në kuadër të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse të Policisë së Kosovës, si ndarje e veçantë organizative. Kjo Drejtori është e ndarë në sektorë, por që në praktikë nuk funksionon një ndarje e tillë sektoriale. Ndarja e aprovuar sektoriale shtron nevojën e ndërmarrjes së hapave të nevojshëm nga menaxhmenti drejt fuqizimit të një strukture të përshtatshme të funksionimit. Kjo gjendje është vlerësuar edhe në inspektimin e zhvilluar në vitin 2013. Drejtoria ka të angazhuar kapacitete të mjaftueshme të burimeve njerëzore, të mbështetura nga programet trajnuese dhe certifikuese në fushën e prokurimit publik. Drejtoria numëron gjithsej 12 punonjës, prej të cilëve, katër (4) kanë titullin ‘master’, pesë (5) kanë të kryer shkollimin superior universitar, dy (2) shkollimin e lartë universitar dhe një (1) shkollimin e mesëm. Personeli nga lëmi i prokurimit ka një përvojë mesatarisht prej tetë (8) vitesh që konsiderohet të jetë nivel i kënaqshëm për të përmbushë kërkesat profesionale për fushën përkatëse. Shumica e punonjësve janë të përfshirë në programet trajnuese dhe certifikuese të organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP). Programet e tilla kanë krijuar parakushte që personeli të jetë në hap me ndryshimet legjislative.

3.1.2. Funksionimi i Drejtorisë është i ndërlidhur me aktivitetin e disa akterëve tjerë, aktivitetet e të cilëve janë pjesë e pandashme e një angazhimi të përbashkët. Duhet përmendur ndërlidhjen e Drejtorisë së Prokurimit me Drejtorin e Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse, në kontekstin e funksionimit organizativ dhe operacional. Në rrafshin e funksionimit organizativ, Drejtori është përkujdesur që Drejtoria e Prokurimit të ketë burimet e mjaftueshme njerëzore dhe profesionale për të ushtruar aktivitetet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Duke iu referuar përgjegjësive dhe detyrave që lidhen me Zyrtarin Kryesor Administrativ (ZKA), ai është përfshirë në sigurimin e vlerësimit formal të nevojave dhe në iniciimin e secilit aktivitet të prokurimit, në të gjitha rastet e emërimit të menaxherëve të projekteve ka vepruar në ndarjen e detyrave për mbikëqyrjen e përmbushjes së kushteve kontraktuale dhe ka aprovuar përbërjen e komisioneve të vlerësimit të tenderëve. Edhe roli i njësive kërkuese është vlerësuar të jetë prioritar. Nuk është gjetur të jetë iniciuar ndonjë aktivitet prokurues nga ndonjë njësi kërkuese jo kompetente. Njësitë e kërkesës konform rregullave në fuqi kanë iniciuar kërkesat për prokurim për secilin aktivitet të prokurimit që ka qenë objekt inspektimi. Kërkesat për iniciim të aktiviteteve të prokurimit janë përcjellë me specifikime teknike të propozuara, termat e referencës, paramasat dhe parallogaritë. Nga lëndët e kontrolluara vërehet se nuk ka kufizime në specifikime teknike dhe terma të referencës që do të kufizonin konkurrencën maksimale. Njësitë e kërkesës janë përfshirë në komisione të hapjes dhe vlerësimit të tenderëve, përveç atyre që janë përfshirë në hartimin e specifikimeve teknike.

3.1.3. Nga kontrolli i dosjeve të prokurimit shihet se Drejtoria e Prokurimit ka menaxhuar me të gjitha aktivitetet e prokurimit të AK-se, brenda kompetencave dhe në pajtim me dispozitat e LPP-së. Në konsultim me të gjitha departamentet ka luajtur rol prioritar në nxjerrjen e Planit Vjetor të Prokurimit. Është vërejtur një bashkëpunim i kënaqshëm me njësitë kërkuese rreth nxjerrjes së specifikimeve teknike dhe propozimit të anëtarëve të komisioneve (të hapjes dhe të vlerësimit). Drejtoria e Prokurimit është përkujdesur në mbajtjen e një Regjistri Përmbledhës të aktiviteteve të Prokurimit. Në baza të rregullta vjetore ka hartuar dhe dorëzuar në KRPP, Raportin Vjetor të Kontratave Publike të Nënshkruara.

3.1.4. Për dallim nga inspektimi i kaluar, në Drejtori vërehet një rregullsi e dosjeve të prokurimit, duke bërë që kjo të ketë një Regjistër Përmbledhës të Prokurimit. Brenda çdo dosjeje shihet një klasifikim i kënaqshëm i dokumenteve. Dosjet e kërkuara nga IPK-ja kanë qenë lehtë të qasshme, duke iu falënderuar punës dhe përkushtimit të zyrtarëve të Drejtorisë, duke siguruar një sistemim të duhur të dosjeve të prokurimit. Në inspektimin e kaluar, IPK-ja kishte vërejtur ngecje në mbajtjen e një Regjistri Përmbledhës me informata dhe dokumentet e nevojshme dhe lidhur me gjendjen e krijuar kishte rekomanduar mirëmbajtjen e një Regjistri të tillë, duke promovuar transparencën dhe arkivimin e duhur të dosjeve të prokurimit. Këtë vit është vërejtur se edhe komunikimi përmes postës elektronike është vënë në kuadrin e dosjeve të prokurimit. IPK-ja nuk ka vërejtur se për ndonjërin nga aktivitetet e prokurimit është ushtruar ankesë edhe pse një numër aktivitetesh të kontrolluara janë organizuar procedura të ri-tenderimit dhe ri-kuotimit. Herëve tjera nëse për aktivitetet e tilla janë ushtruar ankesa, nevojitet që ato të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit. IPK-ja çmon përparimet në mbajtjen e evidencave të aktiviteteve të prokurimit dhe inkurajon Drejtorinë që të vazhdojë edhe në të ardhmen me këtë përkushtim, drejt krijimit të një Regjistri Përmbledhës dhe gjithëpërfshirës mbi aktivitetet e prokurimit të PK-së.

3.1.5. Lidhur me raportimin e aktiviteteve të prokurimit, legjislacioni aktual ka përcaktuar që çdo vit të raportohet rregullisht mbi aktivitetet e ndërmarrë nga AK-të në fushën e prokurimit publik. Është konstatuar se Drejtorja ka pasqyruar angazhimet në Raportin Vjetor të Kontratave Publike të Nënshkruara për vitin 2016 dhe të njëjtin, brenda afateve kohore e ka dorëzuar në KRPP, në formë standarde të përcaktuara. Ky hap është ndërmarrë konform rregullave të përcaktuara me LPP. Prodhimi i këtij Raporti është paraparë me legjislacionin primar dhe atë sekondar të prokurimit. Inkurajohet Drejtorja e Prokurimit që të vazhdojë me respektimin e parimeve të transparencës dhe llogaridhënies, duke prezantuar të gjitha aktivitetet prokuroese në kuadër të PK-së.

3.1.6. Ekipi i inspektimit ka inspektuar hapësirën ku janë sistemuar dosjet e prokurimit, pasi një nga rekomandimet e kaluara ka pasur të bëjë pikërisht me sigurimin e hapësirave të mjaftueshme për vendosjen, sistemimin dhe arkivimin e tyre. Ekipi i inspektimit ka vlerësuar se Drejtorja ka në dispozicion hapësira të mjaftueshme për sistemim dhe vendosje të dosjeve të prokurimit. Hapësirat për dosje të prokurimit janë të ndara në dy lokacione të ndryshme, varësisht nga vjetërsia e dosjeve apo aktiviteteve të përfunduara të prokurimit. Në këtë drejtim vërehet lëvizje pozitive dhe kjo ndihmon në mbajtjen e evidencave dhe promovon transparencën.

## **3.2. Administrimi i aktiviteteve të prokurimit**

3.2.1. Çdo AK është i obliguar që aktivitetet prokuroese t'i bazojë në një plan të prokurimit, që sipas rregullave duhet përgatitur në dy faza, herën e parë, si planifikim paraprak, kurse, herën e dytë si planifikim përfundimtar. Bazuar në Planifikimin Vjetor të Prokurimit<sup>1</sup> për vitin fiskal 2016, kjo Drejtori ka dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP), dokumentin me të cilin ka planifikuar furnizimet, shërbimet dhe punët për periudhën e ardhshme 12 mujore. Nxjerrja e Planit të Prokurimit eliminon nevojën për prokurime emergjente, shmangë ndarjen e kërkesave me natyrë të njëjtë prokuroese, mbledhë kërkesat për të fituar vlerën për paranë për të reduktuar kostot dhe mundëson identifikimin e kontratave kornizë. Ky Planifikim Vjetor është përgatitur pas shpalljes

<sup>1</sup> Drejtorja e Prokurimit, *Planifikimi i Prokurimit për vitin fiskal 2016*, Prishtinë.

së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal. Planifikimi i Prokurimit është dorëzuar brenda afateve kohore, siç është përcaktuar në nenin 8, paragrafi 2 të LPP-së. Planifikimi i Prokurimit ka përcaktuar gjithsej 147 aktivitete të prokurimit, prej të cilave, 96 janë aktivitete të furnizimeve, 21 aktivitete të shërbimeve dhe 30 aktivitete të punëve.

3.2.2. Edhe pse qëllimi i Planifikimit të Prokurimit është që të shmangë ndarjen e kërkesave, në disa raste ky Planifikim ka ndarë aktivitetet e prokurimit, siç është rasti me furnizimet me tonerë për fotokopje, furnizimet me gjeneratorë, furnizimet me pjesë për Toyota, furnizimet me material harxhues-shampon për autolarje, etj. Duke iu referuar Raportit Vjetor të Kontratave Publike të Nënshkruara të vitit 2016<sup>2</sup>, kemi ndarje kërkesash të realizuara në këtë periudhë vjetore, siç është rasti me sigurimin e transportit për zyrtarët policor, furnizimi me veshmbathje, furnizime pastrimi, furnizimi me barriera, furnizimi me tonerë, etj. Drejtorja duhet të jetë më e përkushtuar në nxjerrjen e planeve të ardhshme që sigurojnë mos ndarje të kërkesave për të fituar vlerën për paranë, për të nxjerrur konkurrencën në mesin e operatorëve. Ndarja e kërkesave konsiderohet se ngritë kostot dhe humbë kohë në përgatitjen e procedurave të ndara.

3.2.3. Edhe pse planet e prokurimit paraqesin një kornizë të projekteve që priten të realizohen brenda 12 muajve, mbi bazën e përvetësimeve që e siguron korniza e aprovuar buxhetore, Raporti Vjetor i Kontratave Publike të Nënshkruara dëshmon se shumë projekte të planifikuara nuk kanë arritur të realizohen. Bazuar në krahasimet në mes të projekteve të përfshira në Planifikimin e Prokurimit dhe Raportit Vjetor të Kontratave Publike të Nënshkruara, shihet se nga gjithsej 147 projekte të planifikuara në fushat e furnizimit, shërbimeve dhe punëve, pjesë e konsiderueshme e tyre nuk janë realizuar. Janë identifikuar mbi 40 projekte tjera që nuk kanë qenë të përfshira në Planifikimin e Prokurimit e që janë realizuar në vitin 2016. Këto e bëjnë Planin e Prokurimit jo gjithëpërfshirës dhe jo të qëndrueshëm. Me këtë paraqitje shtrohet nevoja e ngritjes së përkushtimit në radhët e Drejtorisë, në nxjerrjen e planeve të bazuara në projekte dhe buxhet të qëndrueshëm dhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit me njësitë kërkuese, në vënien e kërkesave të tyre për projektet. Duke mos lënë anash edhe mbështetjen e menaxhmentit të lartë ekzekutiv, nevojiten të ndërmerren hapat e tillë drejt nxjerrjes së planeve që adresojnë realizimin e projekteve me prioritet dhe të përgatitura mirë teknikisht.

#### **Rekomandimi nr. 1**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që në të ardhmen të shtojë përpjekjet që në bashkëpunim me departamentet tjera, të hartojë plane vjetore të prokurimit më gjithëpërfshirëse dhe më përmbajtësore, të cilat eliminojnë nevojën për prokurime emergjente, shmangin ndarjen e kërkesave me natyrë të njëjtë prokuruese, mbledhin kërkesat për të fituar vlerën për paranë për të reduktuar kostot dhe mundësojnë identifikimin e kontratave kornizë.*

3.2.4. Aktiviteti i prokurimit 214/16/157/136 (Furnizim me pajisje të zërimit) nuk është përfshirë në Planifikimin e Prokurimit për vitin fiskal 2016. IPK-ja nuk ka gjetur dëshmi se Deklarata e Nevojave dhe Vlerësimi i Disponueshmërisë së Fondeve (DNVDF) është dorëzuar në AQP. Duke konsultuar Planifikimin e Prokurimit për vitin 2016, ky aktivitet edhe pse nuk është planifikuar, në DNVDF është prezantuar si aktivitet i planifikuar në vlerë prej 9.900 € Edhe aktiviteti 214/16/046/111

<sup>2</sup> Drejtorja e Prokurimit, *Raporti Vjetor i Kontratave Publike të Nënshkruara (2016)*, datë 25 janar 2017, Prishtinë.

(Furnizimi me letër A-4) nuk është përfshirë në Planin e Prokurimit për vitin 2016 dhe nuk është dorëzuar DNVDF-ja në AQP. Për rastet e tilla veprohet sipas nenit 9, paragrafi 6 të LPP-së. Sipas kësaj dispozite, nëse objektet e aktivitetit të prokurimit nuk janë përfshirë në planifikimin përfundimtar të AK-së, ZKA-ja duhet të dërgojë në AQP, një kopje të DNVDF-së, së paku pesë (5) ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit përkatës të prokurimit. Në inspektimin e vitit 2013, IPK kishte rekomanduar respektimin e dispozitës ligjore për nxjerrjen e DNVDF-ve dhe shihet lëvizje pozitive, ngase ekipi i inspektimit nuk ka gjetur ndonjë rast që nuk është respektuar kjo dispozitë. Çmohet përkushtimi dhe mobilizimi i Drejtorisë për përbushjen e rekomandimit drejt respektimit të kësaj dispozite ligjore.

3.2.5. Bazuar në nenin 21 të UOPP-së (Lëshimi i dokumenteve të tenderit), për secilin aktivitet të prokurimit, AK-ja duhet të prodhojë një regjistër të OE-ve që pranojnë Dosjen e Tenderit (DT), duke përdorur formën standarde të aprovuar nga KRPP-ja. Në aktivitetin e prokurimit 214/16/054/121 (Furnizimi me tonerë për fotokopje) nuk është gjetur brenda dosjes së prokurimit se është mbajtur një regjistër i tillë. Në aktivitetin e prokurimit 214/16/047/147 (Furnizim me ngjyra për ploter DIA) të udhëhequr si procedurë për kontrata me vlerë minimale, nuk është nxjerrë Regjistri i OE-ve të Kontaktuar. Në inspektimin e kaluar, IPK ka rekomanduar që në drejtim të ngritjes së transparencës, të respektohet Udhëzuesi lidhur me prodhimin e Regjistrin të OE-ve të Kontaktuar. Duke parë se ky rekomandim nuk është përbushur, Drejtoria duhet të mobilizohet në përbushjen e tij. UOPP-ja në nenin 48 (Procedura për kontrata me vlerë minimale) përcakton se së paku tre (3) operatorë të mallrave/shërbimeve/punëve duhet të kontaktohen dhe AK-ja është e obliguar të dokumentoj duke prodhuar Regjistrin e OE-ve të Kontaktuar, që së paku tre (3) OE janë kontaktuar.

#### ***Rekomandimi nr. 2***

*IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që në drejtim të ngritjes së transparencës së aktiviteteve të prokurimit, gjatë zbatimit të procedurave për kontratat me vlera minimale të respektojë udhëzimet që dalin nga Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, lidhur me prodhimin e Regjistrin të Operatorëve Ekonomik të Kontaktuar.*

3.2.6. IPK-ja është angazhuar në vlerësimin e nivelit të përbushjes së rekomandimeve lidhur me respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë afatet kohore, në mënyrë që DT-të të përmbajnë afate kohore që ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për përgatitjen e tyre, bazuar në legjislacionin aktual. Vërehet lëvizje pozitive në këtë drejtim dhe vlerësohet se nuk është identifikuar asnjë rast që nuk janë respektuar afatet minimale kohore për pranimin e tenderëve. IPK çmon angazhimet e Drejtorisë në respektimin e dispozitës lidhur me afatet kohore ligjore. Hapat e këtyre u ofrojnë OE-ve kohë të mjaftueshme për të përgatitur ofertat e tyre.

3.2.7. Inspektimi i kaluar kishte vënë në pah vonesa të shkaktuara në përgatitjen me kohë të DT-ve. Ishin identifikuar raste kur dosjet e tilla tenderuese janë përgatitur pas publikimit të Njoftimeve të Kontratave. Në këtë inspektim të fundit nuk është evidentuar asnjë rast i vetëm i kësaj natyre. Është identifikuar një problematikë tjetër lidhur me dorëzimin DT-ve nga AK. Në aktivitetin e prokurimit 214/16/104/136 (Furnizimi me revistën 'Mbrojtësi'), në Regjistrin e OE-ve që kanë pranuar DT-në figuron edhe një OE, por që nga kontrolli i dosjes së prokurimit del që nuk i është dhënë DT-ja edhe pse e ka kërkuar atë. Duke kontrolluar komunikimin në mes të AK-së dhe OE-së, shihet se AK-ja i ka kërkuar këtij të fundit disa të dhëna informuese. OE nuk ka pranuar DT-në, me gjithë faktin që

disa nga informatat e kërkuara i ka përmbajtur kërkesa e tij e datës 19.05.2016. DT-ja nuk i është dhënë me kohë edhe një OE-je në aktivitetin e prokurimit 214/16/091/221 (Matja dhe shqyrtimi i tokëzimit dhe rufepritësit në objekte policore). Është e pa qartë se pse kërkohen informatat të tilla, kur AK-ja sipas nenit 48, paragrafi 1 të LPP-së (Dorëzimi i dosjes së tenderit), ka obligim t'ia dorëzojë operatorit, dosjen e kërkuar të tenderit pa pagesë, nëse ai ka parashtruar me kohë një kërkesë për të marrë një dosje të tenderit që i përmbushë kërkesat e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

### **Rekomandimi nr. 3**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që në drejtim të sigurimit të një konkurrence kualitative brenda një procedure të prokurimit, të respektojë dispozitën ligjore për lëshimin apo dorëzimin e dosjes së tenderit, operatorëve ekonomikë që parashtrojnë kërkesë për të marrë dosjen e tenderit (neni 48, paragrafi 1 i LPP-së).*

3.2.8. Inspektimi i fushës së menaxhimit të prokurimit i realizuar në vitin 2013 kishte vënë në pah dobësi në përgatitjen e specifikimeve teknike dhe ishte rekomanduar që të respektohen dispozitat ligjore lidhur me specifikimet teknike, me nevojën që ato të jenë më të qarta, më të sakta, të mos kufizojnë konkurrencën e lirë dhe të mos diskriminojnë/favorizojnë një ose më shumë OE. Ekipi i inspektimit ka shtjelluar këtë problematikë dhe vlerësohet se janë konsoliduar dukshëm këto procese. Vërehet një përfshirje e njësisë të kërkesave në përgatitjen e ST-ve dhe TR-ve, dhe ato duken se afrojnë një konkurrencë më cilësore. IPK çmon mobilizimin dhe vlerëson se ky avancim i kontribuon ngritjes së konkurrencës cilësore dhe ofrim çmimesh të leverdishme.

3.2.9. Është vërejtur një dukuri tek aktivitetet e prokurimit që zbatojnë procedura për kontrata me vlera minimale, që zyrtarët e prokurimit i nënshkruajnë formularët e çmimeve të kuotuar, para se OE-të t'i dorëzojnë ofertat e tyre. Sipas nenit 48 të UOPP-së, çmimi i kuotuar i nënshkruar nga OE fitues konsiderohet kontratë dhe nënshkruhet nga Zyrtari përgjegjës i Prokurimit. Vlerësohet se çmimi i kuotuar i nënshkruhet vetëm operatorit fitues, vetëm pasi të konstatohet se oferta e tillë është më e lira.

3.2.10. Në inspektimin e kaluar, në kuadër të dosjeve të kontrolluara janë identifikuar disa anomali që kanë shtruar nevojën për ngritjen e përgjegjësisë së Drejtorisë karshi respektimit të Ligjit, e gjithë kjo në drejtim të sigurimit se të gjitha aktivitetet e prokurimit të AK-së ekzekutohen në përputhje me LPP-në. Dobësitë e tilla janë lidhur me rastet kur ofertat janë plotësuar nga operatorët e njëjtë, kontratat janë realizuar para se të nënshkruhen zyrtarisht dhe aplikimi i konkurrencës së kufizuar. Në këtë inspektim nuk janë evidentuar dukuri të tilla dhe çmohet mobilizimi në ngritjen e përgjegjësisë për ekzekutimin e aktiviteteve të prokurimit në frymën e Ligjit.

3.2.11. Në vitin 2013 janë identifikuar raste kur AK-ja nuk ka respektuar afatet kohore të hapjes së tenderëve. Kjo është e evidente edhe më tej dhe Drejtoria duhet të marrë seriozisht këtë, duke qartësuar nëse kemi të bëjmë me lëshim teknik apo mos respektim të dispozitës. Në aktivitetin 214/16/094/121 (Furnizimi me barriera), tenderët janë hapur para kohe, jo siç është përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe DT, sipas të cilave është përcaktuar që hapja të ndodhë më 17.06.2016, në 14.30. Sipas Procesverbalit të hapjes figuron që tenderët janë hapur në 14.00. Situata të njëjta kemi edhe në disa aktivitete tjera. Sipas Njoftimit të Kontratës dhe DT të aktivitetit 214/16/061/221 (Mirëmbajtja e pikave të antenave) është përcaktuar që hapja e tenderëve të bëhet më 06.07.2016, në 14.30, kurse

sipas Procesverbalit të hapjes së tenderëve, hapja është bërë në të njëjtën ditë, në ora 14.00. Sipas Njoftimit të Kontratës dhe DT të aktivitetit 214/16/058/221 (Blerja e shërbimeve shëndetësore) është përcaktuar që hapja të bëhet më 30.08.2016, në ora 14.30, kurse sipas Procesverbalit, hapja është bërë në të njëjtën ditë, në ora 14.00. Sipas Njoftimit të Kontratës dhe DT të aktivitetit 214/16/106/136 (Furnizim me emblema dhe flamuj shtetëror) është përcaktuar që hapja të bëhet më 21.07.2016, në ora 14.30, kurse sipas Procesverbalit të hapjes së tenderëve, hapja është bërë në të njëjtën ditë, në ora 14.00. Sipas Njoftimit të Kontratës dhe DT-së së aktivitetit 214/16/091/221 (Matja dhe shqyrtimi i tokëzimit dhe rrufepritësit në objekte policore) është përcaktuar që hapja të bëhet më 26.05.2016, në ora 14.30, kurse sipas Procesverbalit të hapjes së tenderëve, hapja është bërë në të njëjtën ditë, në ora 14.00. Sipas nenit 58 të LPP-së (Hapja e tenderëve), të gjithë tenderët e dorëzuar para afatit të fundit kohor për dorëzimin e tenderëve do të hapen në vendin dhe kohën e specifikuar. Sipas paragrafit të parë të këtij neni, AK nuk do të hap tenderët në çfarëdo vendi ose në çfarëdo kohe tjetër.

#### **Rekomandimi nr. 4**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që në të ardhmen të jetë më e përgjegjshme gjatë administrimit të procedurave administrative, duke i kushtuar kujdesin e duhur respektimit të dispozitës ligjore mbi hapjen e tenderëve, konform afateve të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe Dosjen e Tenderit (neni 58 i LPP-së).*

3.2.12. Në aktivitetet 214/16/094/121 (Furnizimi me barriera), 214/16/043/521 (Renovimi i sallës për takime në Stacionin Policor të Pejës) dhe 214/16/106/136 (Furnizimi me emblema dhe flamuj shtetëror), Procesverbalet e hapjes nuk janë nënshkruar nga Zyrtarët e Prokurimit. Në aktivitetin 214/16/054/121 (Furnizimi me tonerë për fotokopje) nuk dihet koha e saktë e hapjes së tenderëve, ngase Procesverbali i hapjes nuk përmban kohën dhe vendin e hapjes së tenderëve. Në Vendimin për krijimin e komisionit të hapjes së tenderëve është përcaktuar koha e hapjes së tenderëve. Sipas Procesverbalit të hapjes së tenderëve, nuk ka pasur përfaqësues të OE-ve në mbledhjen e hapjes publike të tenderëve. Lëshime të kësaj natyre janë evidentuar edhe në inspektimin e kaluar dhe është e nevojshme që këto çështje të merren në konsideratë nga Drejtoria e Prokurimit. Sipas nenit 58, paragrafi 3 të LPP-së, të gjitha informatat që lexohen do të regjistrohen në Procesverbalin e hapjes publike të tenderëve, i cili në fund të mbledhjes do të nënshkruhet nga Zyrtari përkatës i Prokurimit, anëtarët e komisionit të hapjes dhe secili përfaqësues i tenderuesit që janë të pranishëm në mbledhje.

#### **Rekomandimi nr. 5**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që në të ardhmen të përkushtohet në respektimin e dispozitës ligjore mbi përfshirjen e informatave të nevojshme në procesverbalet e hapjes së tenderëve, përfshirë edhe nënshkrimet e personave të përfshirë në procedurën e hapjes (neni 58, paragrafi 3 i LPP-së).*

3.2.13. Fusha e krijimit dhe përbërjes së komisioneve të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ishte konsideruar si problematike në inspektimin e kaluar. IPK-ja kishte rekomanduar që Drejtoria të respektojë rregullat mbi themelimin e këtyre komisioneve, duke qartësuar edhe rolin e zyrtarëve të prokurimit në fazën e vlerësimit. Inspektimi ka dëshmuar se janë eliminuar dobësitë e tilla dhe ekziston një qartësi për rolin e personelit të përfshirë në procedurë vlerësimi. Është kuptuar roli i Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit dhe është avancuar aspekti kualitativ i pjesëmarrjes së anëtarëve nga njësitë kërkuese dhe të ekspertëve në kuadër të komisioneve të vlerësimit të tenderëve.

Me gjithë konsolidimin e bërë, janë identifikuar dy aktivitete që në të ardhmen duhet kushtuar kujdes dhe kërkojnë kujdesin e duhur. Në aktivitetin e prokurimit 214/16/024/211 (Mirëmbajtja, servisimi dhe kalibrimi i pajisjeve VSC-QC1), sipas Procesverbalit të hapjes të datës 18.05.2016, njëri anëtar i komisionit të hapjes nuk është siç është përcaktuar me Vendimin për themelimin e komisionit të hapjes. Në aktivitetin 214/15/139/136 (Furnizimi me libra të raporteve të aksidentit- ri-kuotim 2), përbërja e komisioneve të hapjes dhe vlerësimit është nga aktiviteti i prokurimit paraprak (ri-kuotim 1). Sipas UOPP-së, neni 40, pika 40.2, komisioni vlerësues formohet prej rastit në rast.

3.2.14. Në aktivitetin 214/16/098/121 (Furnizimi me pjesë rezervë për autobus Tamsa Opalin), të gjithë tenderët përmbajnë shuma që tejkalojnë buxhetin e AK-së. Në këtë rast, është plotësuar kushti kur AK ka mundur të ndërpres procedurën e prokurimit sipas nenit 62, paragrafi 2, pika 2.1 të LPP-së (Përfundimi i aktivitetit të prokurimit). Me gjithë që vlera e kontratës është llogaritur të jetë e vlerës së mesme, ka vazhduar procesi i dhënies së kontratës duke kaluar në kontratë me vlerë të madhe dhe fitues është shpallë OE që ka tenderuar me çmimin shumë më të lartë se buxheti i lejuar. Vlera e parashikuar e kësaj kontrate me vlerë të mesme është llogaritur të jetë 120.000 €, kurse kontrata është nënshkruar në lartësi prej 152.391,50 €. Vlerësohet se në të ardhmen duhet kushtuar kujdes situatave të tilla në mënyrë që të mos tejkalohej vlera e parashikuar e kontratës, ngase procedura është organizuar si vlerë e mesme, me çka afatet kohore për pranimin e tenderëve kanë qenë më të shkurtra. Veç tjerash, vlera e tenderit fitues ka tejkalluar limitet e buxhetit të aprovuar.

3.2.15. Inspektimi i vitit 2013 kishte ekzaminuar disa raste kur procedura e vlerësimit nuk kishte filluar brenda afatit 96 orësh nga hapja e tenderëve. Lidhur me këtë ishte rekomanduar respektimi i Udhëzuesit për fillimin me kohë të kësaj faze. Është lëvizur pozitivisht në këtë aspekt dhe lidhur me këtë problematikë është identifikuar një rast i vetëm kur procedura e vlerësimit ka filluar me vonesë. Në aktivitetin 214/16/043/521 (Renovimi i sallës për takime në Stacionin Policor të Pejës), vlerësimi i tenderëve nuk ka filluar brenda afateve të parapara ligjore. Është gjetur mos përputhje e datave të deklaratave nën betim (12.04.2016), datën e përgatitjes së Raportit vlerësues (12.04.2016) dhe datën e shkresës (njoftimit) të kryetarit të komisionit të vlerësimit të tenderëve mbi mos fillimin me kohë të këtij aktiviteti (13.04.2016). Përmes e-mailit zyrtar të kryetarit të komisionit, konfirmohet se vlerësimi fillon më 14.04.2016, që llogaritet jashtë afatit të përcaktuar. Sipas nenit 35 të UOPP-së (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve), procesi i vlerësimit fillon menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 96 orë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve. IPK inkurajon Drejtorinë që të përkushtohet në vazhdimësi në respektimin e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik (RUOPP) lidhur me afatet për fillimin dhe përmbylljen e procesit të vlerësimit të tenderëve.

3.2.16. Në aktivitetin e prokurimit 214/16/047/147 (Furnizim me ngjyra për ploter) nuk është nxjerrë Procesverbali i çmimeve të kuotuar. Ky dokument nuk është nxjerrë edhe në aktivitetin tjetër të prokurimit 214/16/096/147 (Furnizim për zyrë). Në inspektimin e kaluar, IPK ka rekomanduar që në drejtim të ngritjes së transparencës, të respektohet Udhëzuesi mbi përgatitjen e Procesverbalit të çmimeve të kuotuar. Duke parë se rekomandimi nuk është përmbushur, Drejtoria duhet mobilizuar në përmbushjen e plotë të rekomandimit. Sipas nenit 48 të UOPP-së (Procedura për kontrata me vlerë minimale), AK-ja gjatë kontaktimit të OE-ve duhet të marr çmimet e kuotuar duke përdorur formën standarde të aprovuar nga KRPP-ja (Çmimet e kuotuar për vlera minimale). Zyrtari i



Prokurimit duhet ta përgatis Procesverbalin mbi çmimet e kuotuar, i cili do të përmbajë emrat dhe adresën e OE-ve të kontaktuar si dhe çmimet e ofruara.

**Rekomandimi nr. 6**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që në drejtim të ngritjes së transparencës së aktiviteteve të prokurimit, gjatë zbatimit të procedurave për kontratat me vlera minimale, të respektojë udhëzimet që dalin nga Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik lidhur me përgatitjen e Procesverbalit të çmimeve të kuotuar.*

3.2.17. Në aktivitetin e prokurimit 214/16/096/147 (Furnizim për zyrë), AK-ja ka kontaktuar disa OE më 11.05.2016, duke i njoftuar se ofertat e tyre do të dorëzohen të nesërmen më 12.05.2016. Me gjithë zgjatjen e afatit për pranim të ‘çmimeve të kuotuar’ nga operatorët e kontaktuar deri më 13.05.2016, ofertat e tyre janë dorëzuar më 16.05.2016. AK-ja është dashur të respektojë nenin 19 të UOPP-së (Afatet kohore). IPK ka trajtuar dosjen e prokurimit dhe ka vërejtur se nuk janë kryer përgatitjet e duhura për të proceduar me aktivitetin, andaj edhe janë paraqitur vështirësitë. Duhet pasur kujdes në respektimin e afateve pa marrë parasysh vlerat minimale të kontratave.

3.2.18. Inspektimi i kaluar kishte shtruar nevojën për ngritjen e masave për të siguruar seriozitetin në trajtimin e tenderëve, duke rekomanduar që të respektohen dispozitat ligjore në përzgjedhjen e OE-ve të suksesshëm, bazuar në kriteret e përcaktuar të përzgjedhjes. Me gjithë konsolidimin e procesit përzgjedhës, janë identifikuar dy raste ku nuk është krijuar qasje e duhur drejt përzgjedhjes së ofertës më meritore. Në aktivitetin 214/16/041/221 (Pastrimi i automjeteve të PK-së), edhe pse formulari i dorëzimit të tenderit të njërit prej OE-ve ka qenë i pa nënshkruar, i njëjti është vlerësuar si tender i përgjegjshëm dhe është shpall fitues për lotin e parë. Formulari i tillë nuk është plotësuar si duhet, me çka ka paraqitur kusht administrativ. Në Raportin e vlerësimit, te faqja e kërkesave formale administrative është deklaruar se tenderi ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë administrative. Në aktivitetin 214/16/091/221 (Matja dhe shqyrtimi i tokëzimit dhe rrufepritësit), nuk është përfillë neni 59 i LPP-së. OE nuk ka përmbushur kushtet e përshtatshmërisë profesionale dhe është shpallur fitues. OE nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara me Njoftimin e Kontratës dhe DT. Komisioni i vlerësimit ka pranuar ofertën si të përgjegjshme edhe pse nuk ka prezantuar dëshmitë valide të kërkuara. Vlerësimi nuk është i bazuar për shkak të trajtimit dhe qasjes jo të duhur në vlerësimin e certifikatës së Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), certifikatës së regjistrimit të biznesit, diplomës së inxhinierit, certifikatës për matje të rezistencës së tokëzimit e rrufepritësit. OE është shpallë fitues i kontratës edhe pse ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve bie në kundërshtim me nenin 59, paragrafi 4 të LPP-së. Sipas kësaj dispozite, AK do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse ai është në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin e Kontratës dhe DT.

**Rekomandimi nr. 7**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që gjatë shqyrtimit të tenderëve në fazën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit, të ndër marrë masat e nevojshme administrative në respektimin e dispozitave ligjore për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë bazuar në kriteret e përcaktuara me Njoftimin e Kontratës dhe Dosjen e Tenderit (neni 59, paragrafi 4 i LPP-së).*

3.2.19. Në drejtim të ngritjes së vazhdueshme të transparencës dhe ofrimit të informatave të duhura mbi procedurën e prokurimit, del se organizata ka ecur para. Inspektimi i kaluar kishte rekomanduar Drejtorinë që të angazhohet në respektimin e dispozitave mbi njoftimin e kandidatëve të eliminuar mbi rezultatet e aktivitetit prokurues. Me gjithë ngritjen e performances, mbetet ende për të punuar në respektimin e dispozitave mbi publikimin me kohë të njoftimeve për dhënien e kontratave. Në aktivitetin 214/16/167/121 (Furnizimi me pjesë për Audi, Shkoda, BMW, Jeep Cherokee, Volvo, Seat, Mercedes, Citroen, Peugeot, Ford) është vonuar publikimi i Njoftimit për Dhënie të Kontratës. Raporti i vlerësimit të tenderëve është nënshkruar nga Zyrtari përgjegjës i Prokurimit më 09.12.2016, kurse sipas e-mailave zyrtar me KRPP-në, shihet se Njoftimi për Dhënie të Kontratës është dërguar në KRPP, më 14.12.2016. Vonesë në publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës kemi edhe në aktivitetin 214/16/043/521 (Renovimi i sallës për takime në Stacionin Policor të Pejës). Raporti i vlerësimit është nënshkruar nga Zyrtari i Prokurimit më 16.05.2016, kurse data e përgatitjes së Njoftimit për Dhënie të Kontratës është 20.05.2016. Sipas nenit 41 të LPP-së (Njoftimi për Dhënie të Kontratës), nëse AK-ja ka dhënë një kontratë publike duke përdorë procedurë të hapur, të kufizuar, konkurruese me negociata, të negociuar pa publikim ose procedurë kuotimi të çmimeve, brenda dy (2) ditëve pas dhënies së kontratës së tillë, do të përgatis Njoftimin për Dhënien e Kontratës.

#### **Rekomandimi nr. 8**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që pas përmbylljes së fazës së përzgjedhjes së operatorit më të suksesshëm ekonomik, të ndërmarr hapat e nevojshëm procedural të publikimit të Njoftimit të Dhënies së Kontratës, brenda afateve kohore të përcaktuara me nenin 41 të LPP.*

3.2.20. Në aktivitetin e prokurimit 214/15/024/121 (Furnizim me këpucë dhe çizme për punëtorët e PK-së) nuk është publikuar Njoftimi për Nënshkrimin e Kontratës. IPK e ka të qartë se ky aktivitet është ndërmarrë para amendamentimit të ligjit, me çka ka hyrë në fuqi edhe dispozita mbi publikimin e Njoftimit për Nënshkrimin e Kontratës, por pas hyrjes në fuqi të dispozitës në fjalë (21.01.2016) del se është bërë Njoftimi i Dhënies së Kontratës më 27.01.2016, me çka kuptohet se është dashur të publikohet edhe Njoftimi për Nënshkrimin e Kontratës. Sipas nenit 41/A të LPP-së (Njoftimi për Nënshkrimin e Kontratës), nëse AK-ja ka nënshkruar një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura, të kufizuara, konkurruese me negociata, të negociuara pa publikim, procedurat e kuotimit të çmimeve, ose procedurat me vlera minimale, brenda dy (2) ditëve pas nënshkrimit të kontratës së tillë, do të përgatisë Njoftimin për Nënshkrimin e Kontratës.

3.2.21. Nënshkrimi i kontratave është vlerësuar si pikë pozitive e këtij inspektimi, me çka shihet se ato janë nënshkruar konform afateve kohore dhe gjithmonë pas shqyrtimit të disponueshmërisë së fondeve, publikimit të Njoftimit të Dhënies së Kontratës dhe kalimit të fazës së ankimimit eventual. Konsiderojmë se ato janë nënshkruar nga autoritetet apo nivelet e përcaktuara me ligj. Kjo pikë ishte vlerësuar në të kaluarën si pikë e ndjeshme, andaj çmohet serioziteti dhe përkushtimi i personelit në përmirësimin e kësaj performance.

3.2.22. Inspektimi ka vënë në pah disa lëshime që kanë të bëjnë me hapat procedural brenda fazës së menaxhimit të kontratave. Udhëzuesi ka përcaktuar hapat që duhet ndërmarrë. Nevojitet të kihet kujdes në fazën e menaxhimit të kontratave. Në aktivitetin 214/16/075/136 (Furnizim me pjesë për automjete Mercedes Benz B-180 D, Opel Astra 1.9 CTDI, Opel Astra 1.7 CTDI, Peugeot 307 HDI), Urdhër blerja është lëshuar më 25.04.2016, para nxjerrjes dhe nënshkrimit të Planit të Menaxhimit

të Kontratës. Plani i tillë është nënshkruar nga palët më 28.04.2016. Njëjtë është vepruar edhe në aktivitetin “Shërbimet e trajnimit dhe arsimit për patentë- shofer”, ku Plani është nënshkruar nga palët më 10.10.2016, kurse Letra e Njoftimit (në rastin konkret Urdhër blerja) është lëshuar më 05.10.2016. UOPP në nenin 55 (Menaxhimi i Kontratës) përcakton se Zyrtari i Prokurimit do t’i lëshojë OE-së, Urdhërblerjen, në rast të kontratës për furnizime, pas pranimit të Planit të Menaxhimit të Kontratës nga Menaxheri i Kontratës, të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe OE-ja. Në aktivitetin 214/16/054/121 (Furnizim me toner për fotokopje), Plani i Menaxhimit të Kontratës është përgatitur dhe nënshkruar nga palët para se të caktohet Menaxheri i Projektit. Sipas dosjes, Plani i Menaxhimit të Kontratës është nxjerrë më 26.07.2016, kurse ZKA-ja më 02.08.2016, me vendim të veçantë ka caktuar Menaxherin e Kontratës. Sipas nenit 55 të UOPP-së, së pari caktohet Menaxheri i Projektit, mandej nxirret Plani i Menaxhimit të Kontratës dhe më pas lëshohet Urdhër blerja. Në aktivitetin e prokurimit 214/16/061/221 (Mirëmbajtja e pikave të antenave) nuk është nënshkruar Plani i Menaxhimit të Kontratës nga Menaxheri i Projektit. Sipas UOPP-së, Plani i Menaxhimit të Kontratës përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e palëve, Menaxherit të Projektit dhe OE-së. Në aktivitetin e prokurimit 214/16/104/136 (Furnizimi me revistën ‘Mbrojtësi’) nuk ka dëshmi se ZKA ka emëruar Menaxherin e Projektit edhe pse mallin e ka pranuar komisioni. Sipas nenit 55, paragrafi 4 të UOPP-së (Menaxhimi i Kontratës), pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, Zyrtari i Prokurimit do të njoftojë ZKA-në dhe ky i fundit do të emërojë me shkrim një Menaxher të Projektit, përgjegjës për menaxhimin e kontratës specifike dhe për të njoftuar Zyrtarin e Prokurimit.

***Rekomandimi nr. 9***

*IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të ndjekë hapat procedural që lidhen me menaxhimin e kontratës, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik (neni 55 i RUOPP-së).*

## 4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

### 4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 04.01.2018, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Prioritet	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që në të ardhmen të shtojë përpjekjet që në bashkëpunim me departamentet tjera, të hartojë plane vjetore të prokurimit më gjithpërfshirëse dhe më përmbajtësore, të cilat eliminojnë nevojën për prokurime emergjente, shmangin ndarjen e kërkesave me natyrë të njëjtë prokuruese, mbledhin kërkesat për të fituar vlerën për paranë për të reduktuar kostot dhe mundësojnë identifikimin e kontratave kornizë.</i>	<i>I</i>	<i>Policia e Kosovës është në dispozicion 24 orë në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Çdo ndryshim në sferën politike kombëtare ndërkombëtare ndikon drejtpërdrejt në ndryshimin të planifikimit në Prokurim në Policinë e Kosovës.</i>	<i>Janar 2018</i>
2	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që në drejtim të ngritjes së transparencës së aktiviteteve të prokurimit, gjatë zbatimit të procedurave për kontratat me vlera minimale të respektojë udhëzimet që dalin nga Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik lidhur me prodhimin e Regjistrimit të operatorëve ekonomik të kontaktuar.</i>	<i>I</i>	<i>Pajtohem me të gjetur për mos prodhim të regjistrimit, mirëpo Drejtoria e Prokurimit në çdo procedurë me vlerë minimale ka kontaktuar min 3 OE dhe është e dokumentuar.</i>	<i>Mars 2018</i>
3	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që në drejtim të sigurimit të një konkurrence kualitative brenda një procedure të prokurimit, të respektojë dispozitën ligjore për lëshimin apo dorëzimin e dosjes së tenderit, operatorëve ekonomikë që parashatrojnë kërkesë për të marrë dosjen e tenderit (neni 48, paragrafi 1 i LPP-së).</i>	<i>I</i>	<i>Me përdorimin e platformës elektronike OE e regjistruara në platformë do ta shkarkojnë çdo lëndë.</i>	<i>Janar 2018</i>
4	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që në të ardhmen të jetë më e përgjegjshme gjatë administrimit të procedurave administrative, duke i kushtuar kujdesin e duhur respektimit të dispozitës ligjore mbi hapjen e tenderëve, konform afateve të përcaktuara në</i>	<i>I</i>	<i>Pajtohem me këtë të gjetur, dhe ju njoftoj se kjo është një gabim teknik.</i>	<i>Janar 2018</i>

	<i>Njoftimin e Kontratës dhe Dosjen e Tenderit (neni 58 i LPP-së).</i>			
5	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që në të ardhmen të përkushtohet në respektimin e dispozitës ligjore mbi përfshirjen e informatave të nevojshme në procesverbalet e hapjes së tenderëve, përfshirë edhe nënshkrimet e personave të përfshirë në procedurën e hapjes (neni 58, paragrafi 3 i LPP-së).</i>	<i>I</i>	<i>Pajtohem me këtë të gjetur, Drejtoria e Prokurimit do të jetë më përgjegjës në nënshkrimin e procesverbalit nga personat përgjegjës.</i>	<i>Mars 2018</i>
6	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që në drejtim të ngritjes së transparencës së aktiviteteve të prokurimit, gjatë zbatimit të procedurave për kontratat me vlera minimale të respektojë udhëzimet që dalin nga Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik lidhur me përgatitjen e Procesverbalit të çmimeve të kuotuar.</i>	<i>I</i>	<i>Drejtorja e Prokurimit do të respektojë udhëzimet që dalin nga Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik lidhur me përgatitjen e Procesverbalit të çmimeve të kuotuar.</i>	<i>Mars 2018</i>
7	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që gjatë shqyrtimit të tenderëve në fazën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit, të ndërmarr masat e nevojshme administrative në respektimin e dispozitave ligjore për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë bazuar në kriteret e përcaktuara me Njoftimin e Kontratës dhe Dosjen e Tenderit (neni 59, paragrafi 4 i LPP-së).</i>	<i>I</i>	<i>Drejtorja e Prokurimit në fazën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit, do të jetë më e përkushtuar profesionalisht për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë bazuar në kriteret e përcaktuara me Njoftimin e Kontratës dhe Dosjen e Tenderit (neni 59, paragrafi 4 i LPP-së).</i>	<i>Janar 2018</i>
8	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që pas përmbylljes së fazës së përzgjedhjes së operatorit më të suksesshëm, të ndërmarr hapat e nevojshëm procedural të publikimit të Njoftimit të Dhënies së Kontratës, brenda afateve kohore të përcaktuara me nenin 41 të LPP-së.</i>	<i>I</i>	<i>Drejtorja e Prokurimit do të respektojë afatet kohore të përcaktuara me nenin 41 të LPP-së.</i>	<i>Mars 2018</i>
9	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të ndjekë hapat procedural që lidhen me menaxhimin e kontratës, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik (neni 55 i RUOPP-së).</i>	<i>I</i>	<i>Drejtorisë e Prokurimit do të ndjekë hapat procedural që lidhen me menaxhimin e kontratës, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik (neni 55 i RUOPP-së).</i>	<i>Mars 2018</i>

## Shtojcat

Nr.	Gjetjet nga inspektimi i mëparshëm (viti 2013) Inspektimi: Vlerësimi i kryerjes së detyrave në Drejtorinë e Prokurimit të Policisë së Kosovës, nr. 6/2013			Niveli i zbatimit po/jo
	Rekomandimi i dhënë	Komentet e strukturës policore	Afatet për zbatim	
1	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetëse dhe Drejtorit të Prokurimit që të fillojnë me zbatimin e skemës së organizimit të brendshëm.	Gjatë vitit 2012 me anë të konkursit fillimisht është përzgjedhur stafi i cili në mungesë të një strukture organizative, nuk kemi mundur të implementojmë. Tash jemi në fazën e përzgjedhjes së stafit i cili do të caktohet komfor strukturës organizative të aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm PK.		Vlerësimi nga IPK-ja: Nuk është përmbushur
2	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetëse që të përkujdeset në sigurimin e hapësirave të përshtatshme për vendosjen, sistemin dhe arkivimin e dosjeve të prokurimit.	Drejtoria e Prokurimit që nga viti 2013 e ka në dispozicion hapësirën për arkivimin e lëndëve të cilave validiteti i kontratës ju ka skaduar, hapësira gjendet në katin e V në DPP. Ndërsa për projektet aktive e ekziston zyra që nga viti 2012 në katin II me nr. 32		Vlerësimi nga IPK-ja: Plotësisht
3	IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që në drejtim të promovimit të transparencës, të përkujdeset në mbajtjen e Regjistrit përmbledhës të dokumentacionit, në të cilin do të mirëmbahen të gjitha dokumentet për secilin aktivitet të prokurimit (në rast të ekzistimit të dokumenteve elektronike edhe ato duhet të bëhen pjesë e këtij Regjistri).	Lidhur me këtë rekomandim, Drejtoria e Prokurimit ka filluar në vitin 2013 që të mbajt Regjistra përmbledhës të dokumentacionit duke përfshirë edhe dokumente elektronike, duke bërë regjistrimin e të gjithë dokumenteve të një aktiviteti të prokurimit. Kanë qene të evidentuara mirëpo ka munguar fleta hyrëse. Janë dhënë udhëzimet për regjistër përmbledhës. Ky rekomandim është implementuar		Vlerësimi nga IPK-ja: Plotësisht
4	IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të mobilizohet në nxjerrjen e planeve të mirëfillta të prokurimit, duke bashkëpunuar me departamentet tjera, në mënyrë	Janë marre të gjitha veprime që të mos kemi ndarje të kërkesave të natyrës së njëjtë të prokurimeve.		Vlerësimi nga IPK-ja: Pjesërisht

	<i>që planet e tilla të eliminojnë nevojën për prokurime emergjente, të mundësojnë mbledhjen e kërkesave për të fituar vlerën për paranë, të reduktojnë kostot e prokurimit dhe të evitojnë ndarjen e kërkesave që janë kryesisht të njëjta ose të ndërlidhura.</i>			
5	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit dhe ZKA-së që të respektojnë dispozitat ligjore mbi përcaktimin e nevojave që duhet përmbushur dhe inicimin e aktiviteteve prokuruese (Deklarimi i nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve).</i>	<i>Janë marre te gjitha veprimet për deklarimi i nevojave dhe përcaktimi i disponueshmire se fondeve. Është i plotësuar ne tërësi rekomandimi</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>
6	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që në drejtim të ngritjes së transparencës, të respektojë udhëzimet lidhur me prodhimin e ‘Regjistrave të OE-ve të kontaktuar’ dhe ‘Procesverbaleve të çmimeve të kuotuar’ në aktivitetet prokuruese që përdorin procedurat për kontrata me vlera minimale.</i>	<i>Ne lidhje me këtë rekomandim për përdorimin e Regjistrave të Operatoreve ekonomik të kontaktuar si dhe Procesverbalit të hapjes se kuotimeve me vlere minimale jemi duke i përdorë regjistrat dhe procesverbalet për vlere minimale. Shih e-malin dërguar zyrtareve.</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Pjesërisht</i>
7	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorinë së Prokurimit që në drejtim të ngritjes së transparencës, për secilin aktivitet të respektojë udhëzimet lidhur me prodhimin e ‘Regjistrave të OE-ve që kanë pranuar DT/DP’ dhe ‘Regjistrave të dorëzimit të tenderëve’ (formularët standard të aprovuar nga KRPP-ja).</i>	<i>Për këtë rekomandim jemi duke përdore format e regjistrave pasi qe ka qene vërejtje edhe e auditorëve te brendshme. Është adresuar si dhe plotësuar.</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>
8	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të respektojë dispozitat ligjore lidhur me afatet ligjore në mënyrë që OE-ve t’u ofrohet kohë e mjaftueshme për të përgatitur ofertat e tyre.</i>	<i>Te gjitha dispozitat ligjore janë duke u zbatuar sipas LPP-se për afatet kohore qe operatoret ekonomik te kenë kohe për përgatitjen e ofertave.</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>
9	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të sigurojë se të gjitha aktivitetet e prokurimit të</i>	<i>Janë marre te gjitha veprimet për rekomandimin në fjalë. Kuotimet janë reduktuar.</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>

	<i>AK-së ekzekutohen në përputhje me LPP-në, ngase është përgjegjëse që të raportojë mbi aktivitetet që ekzekutohen në një mënyrë që nuk është në pajtim me LPP-në (vërejtjet lidhen me rastet kur plotësimi i ofertave bëhet nga persona të njëjtë, tek kufizimi i konkurrencës, tek realizimi i projekteve para nënshkrimit të kontratave).</i>			
10	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të respektojë dispozitat ligjore që parashohin trajtim të barabartë, transparencë, mos-diskriminim dhe pa anshmëri ndaj palëve, duke kontribuar në orientimin policor drejt krijimit të një sistemi efektiv, efikas dhe ekonomik të shfrytëzimit të fondeve.</i>	<i>Janë marre të gjitha veprimet për rekomandimin në fjalë.</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>
11	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të respektojë rregullat lidhur me afatet ligjore të hapjes së tenderëve.</i>	<i>Jemi duke respektuar rregullat që ka të bëjë me afatet e hapjes së ofertave të tenderëve –kuotim çmimi, sipas ligjit në fuqi.</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Përgjithësisht</i>
12	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të respektojë dispozitat ligjore mbi përfshirjen e informatave të nevojshme në procesverbalet e hapjes së tenderëve (përfshirë nënshkrimin e personave të përfshirë në procedurën e hapjes).</i>	<i>Jemi duke respektuar rregullat që ka të bëjë me procesverbalet e hapjes duke qenë personat anëtarë të hapjes së ofertave prezent me nënshkrimin e procesverbalit.</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Përgjithësisht</i>
13	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të respektojë dispozitat ligjore lidhur me specifikimet teknike, në mënyrë që ato të jenë të qarta, të sakta, precize, të mos kufizojnë në mënyrë të panevojshme konkurrencën e lirë, si dhe të mos diskriminojnë/ favorizojnë një ose më shumë OE.</i>	<i>Janë marr të gjitha veprimet e domosdoshme dhe njëkohësisht është plotësuar.</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Përgjithësisht</i>
14	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të respektojë rregullat mbi themelimin e komisioneve vlerësuese, duke</i>	<i>Për këtë rekomandim jemi duke i respektuar rregullat mbi themelimin e komisioneve e sidomos qartësimin e rolit të</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>



	<i>qartësuar në mënyrën e duhur rolin e zyrtarëve të prokurimit në procedurën e ekzaminimit, vlerësimin dhe krahasimin të tenderëve.</i>	<i>zyrtarit të prokurimit. Bashkangjitur është interpretimi i KRPP për zyrtarin e prokurimit për vlerësimin e ofertave.</i>		
15	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të respektojë rregullat lidhur me afatet ligjore për fillimin dhe përfundimin e periudhës së ekzaminimit, vlerësimin dhe krahasimin të tenderëve.</i>	<i>Është zbatuar ky rekomandim.</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>
16	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të respektojë dispozitat ligjore lidhur me sqarimin e tenderëve, korrigjimet e gabimeve aritmetike dhe njoftimin e pjesëmarrësve mbi ndryshimet e tilla.</i>	<i>Ky rekomandim është plotësuar dhe për të gjitha aktivitetet e prokurimit ku kërkohen sqarimet, korrigjimet aritmetike, i njoftojmë operatorët ekonomik për çdo ndryshim.</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>
17	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të respektojë dispozitat ligjore në përzgjedhjen e OE-ve të suksesshëm bazuar në kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe Dosjen e Tenderit..</i>	<i>Ky rekomandim është plotësuar</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Përgjithësisht</i>
18	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të respektojë dispozitat ligjore lidhur me Njoftimin e kandidatëve apo tenderuesve të eliminuar mbi rezultatet e aktivitetit të prokurimit, në të gjitha rastet kur një gjë e tillë është e përcaktuar.</i>	<i>Ky rekomandim është i plotësuar pasi që të gjithë operatorëve ju dërgojmë letrat standarde të aprovuara nga KRPP</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>
19	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të respektojë procedurat që kanë të bëjnë me nënshkrimin e kontratave dhe menaxhimin e tyre.</i>	<i>Jemi duke i respektuar procedurat që kanë të bëjnë me nënshkrimin e kontratave dhe menaxhimin e tyre</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>
20	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që gjatë realizimit të kontratave publike të arritura me procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës, të sigurohet se ato arrihen duke mos i shkaktuar</i>	<i>Rekomandimi për procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës që ka të bëjë me punët shtese jemi në respektimin e parimeve të ekonomizimit dhe efikasitet jemi duke i minimizuar që te</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>

	<i>dëme buxhetit, në drejtim të respektimit të parimeve të ekonomizimit dhe efikasitetit të shfrytëzimit të mjeteve.</i>	<i>mos kemi raste tjera që ka të beje me punë shtese</i>		
21	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që gjatë realizimit të kontratave publike të arritura me procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës, të sigurohet se ato arrihen duke mos i shkaktuar dëme buxhetit, në drejtim të respektimit të parimeve të ekonomizimit dhe efikasitetit të shfrytëzimit të mjeteve.</i>	<i>Rekomandimi për procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës që ka të beje me punët shtese jemi në respektimin e parimeve të ekonomizimit dhe efikasitetit jemi duke i minimizuar që të mos kemi raste tjera që ka të beje me punë shtese</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>
22	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Prokurimit që të respektojë nenin 63 të LPP-së (Siguria e ekzekutimit), duke synuar që të sigurojë AK-në se do të mund të realizohen me sukses, kontratat e furnizimeve, shërbimeve apo punëve.</i>	<i>Jemi duke respektuar LPP që ka të beje me Siguria e ekzekutimit që të mos kemi lëshime.</i>		<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>